

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"Extra-Tech" SH.P.K**

Sot më datë 06.04.2018 bazuar në legjislacionin në fuqi, konkretisht ligji nr. 9901, datë 99/01/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, ligjin nr. 9723, datë 03/05/2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" si dhe dispozitat përkatëse të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, shtetasit e mëposhtëm në cilësinë e ortakëve kanë vendosur: Themelimin dhe për pasojë nënshkrimin e Aktit të Themelimit, të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Extra-Tech" shpk, aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij akti dhe i bashkëlidhet në formë Shtojce Nr. 1

1. **Erikson Cakoni, i biri i Hasanit, lindur me 24/07/1987 në Rreshen dhe banues po në Tiranë, në adresën: Njesia bashkiake Nr5, Rruga " Ibrahim Kodra Pall2 Ap3" Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit elektronik nr. personal I70724044J.**
2. **Sokol Xheneti, i biri i Luanit , lindur me 20/03/1994 në "Shtoj i Ri" Shkoder dhe banues po në Tiranë, në adresën: Rruga "Tish Daija" Pall Rati Hyrja 31 " Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit elektronik nr. personal J40320093C.**

NENI 1

Krijohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "**Extra-Tech**" Sh.p.k.

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- a.** Asambleja e ortakëve, organi më i lartë vendi-marres.
- b.** Administratori, për drejtimin e politikave financiare të shoqërisë dhe mardhenie me të tretet.

NENI 2

EMËRTIMI

Emërtimi i Shoqërisë është "**Extra-Tech**" Sh.p.k.



NENI 3

SELIA

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: **Njesia Nr.5, Rruga "Komuna e Parisit", Hyrja 1 Nr pasurie 6/332 Zk 8260 Tiranë, Shqipëri.**

NENI 4

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë **me afat të pacaktuar.**

NENI 5

OBJEKTI I SHOQËRISË

4.1 Shoqëria ka për objekt kryerjen e aktiviteteve të mëposhtme, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi:

- Veprimtari në Importim, Eksportim dhe tregetim të paisjeve elektronike, televizorëve, kompjuterëve, printera, telefonave celulare, aparatura elektronike dhe çdo lloj paisje elektronike.
- Veprimtari në mirenajtje të aparaturave të sipërpërmendura, suport teknik, konsulence etj.

NENI 6

KAPITALI THEMELTAR

5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është **10,000 (dhjetë mijë) lekë.**

5.2. Ky kapital është formuar nga themeluesit e shoqërisë duke kontribuar

Z.Erikson Cakoni me 5500 (pesë mijë e pesëqind) Lek, duke zotëruar 55 % të kapitalit duke zotëruar 1 (një) kuotë,

Z.Sokol Xheneti me 4500 (katër mijë e pesëqind) Lek, duke zotëruar 45 % të kapitalit 1 (një) kuotë.



NENI 7
KONTRIBUTET

Kontributi në kapitalin e shoqërisë ofrohet nga Z.Erikson Cakoni, dhe Z.Sokol Xheneti së bashku në cilësinë e ortakëve, të cilët ofrojnë një kontribut në para prej 10,000 (dhjetëmijë) lekë, të barabartë me 100% (njëqind përqind) të kapitalit themeltar, nëpërmjet depozitimit pranë llogarisë bankare në emër të shoqërisë në themelimin e sipër.

NENI 8
TRESFERIMI I KUOTAVE

Kuotat i transferohen të tretëve sipas mënyrave të parashikuara në Statut.

NENI 9
ADMINISTRIMI

- 8.1. Shoqëria mund të administrohet nga një administrator i vetëm ose nga disa administratorë. Administratori/rët do të ushtrojë/në të gjitha kompetencat në përputhje me parashikimet e nenit 95 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", Statutit dhe/ose aktit të emërimit.
- 8.2 Me këtë akt emërohen Administratorë te Shoqërisë Z.Erikson Cakoni dhe Z.Sokol Xheneti.
- 8.3 Administratoret e emëruar në bazë të këtij akti do të ketë të gjitha kompetencat që parashikohen për administratorët në këtë akt themelimi dhe statutin e shoqërisë duke vepruar se bashku apo vec e vec per interesat e shoqerise.
- 8.4 Administratori do të kete këto kompetenca:

Kompetenca të përgjithshme përfaqësimi:

- Kompetencë për të përfaqësuar Shoqërinë duke kryer çdo akt të konsideruar si i nevojshëm në interes të vetë Shoqërisë;
- Kompetencë për të nënshkruar të gjithë korrespondencën, faturat e lëshuara nga Shoqëria dhe mandatet bankare, të pranojë, xhirojë, arkëtojë dhe të lëshojë vërtetime për pagesat, kambialet;



- Kompetencë për të paraqitur kërkesa, rekurse dhe ankime, të përfaqësojë Shoqërinë para çdo autoriteti gjyqësor dhe administrativ, kombëtar ose të huaj, si palë paditëse apo e paditur, të natyrës fiskale dhe tregtare, në çdo shkallë dhe gradë, edhe në gjykimet në apel, në Gjykatën e Lartë, kompetencë për të proceduar me titujt ekzekutiv, të kujdeset për revokimin, kompetencën për të ndërhyrë dhe kërkuar kreditë në procedura falimentimi dhe të paraqesë deklaratat përkatëse, të emërojë avokatë, përfaqësues të posaçëm në gjykime dhe ekspertë, të kryejë transaksione, të emërojë arbitra dhe ndërmjetësa dhe të nenshkruaj aktet përkatëse të zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjeve;
- Të përfaqësojë Shoqërinë para çdo autoriteti qeverisës, rajonal, dhe komunal, para administratave vartëse dhe enteve të tjera, duke paraqitur kërkesa, rekurse, denoncime dhe ankime të çdo lloji, si dhe për të siguruar lëshimin e licencave dhe autorizimeve të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit të Shoqërisë dhe për çdo aktivitet tjetër të përshtatshëm;

Kompetenca administrative:

- Të përfaqësojë Shoqërinë para çdo autoriteti të sigurisë publike, me të drejtën për të bërë deklaratat, denoncime dhe ankime që do të jenë të nevojshme;
- Kompetencë për të kryer çdo operacion për vendosjen e kufizimeve, heqjen e kufizimeve, dorëzimin, tërheqjen dhe sigurimin e mallrave me të gjitha zyrat, shoqëritë dhe ndërmarrjet publike dhe private të transportit, si dhe para administratave doganore, kombëtare dhe të huaja.
- Kompetenca për të marrë përsipër detyrime për llogari të Shoqërisë, për të kërkuar pagesën e kredive të çdo lloji, të marrë pagesa, mandate, parapagime, urdhra-postar, çeqe të çdo lloji, depozita garancie nga bankat dhe institute të tjera të kreditit dhe nga zyrat postare e telegrafike dhe nga çdo zyrë tjetër apo ente publik dhe privat, duke lëshuar vërtetim të vlefshëm;
- Të marrë pjesë në gara dhe tendera të organizuara nga administrata publike, nga ente publike dhe private dhe nga të tretë, për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve dhe të paraqesë ofertat përkatëse.




Kompetenca në lidhje me operacionet bankare dhe financiare:

- Kompetencë për të krijuar llogari bankare në emër dhe shoqërisë si dhe për të, firmosur xhirimin e çeqeve të llogarive rrjedhëse bankare, çeqeve të xhirueshme, urdhrave kambiale dhe postare për kreditimin e llogarive rrjedhëse të regjistruara në emër të Shoqërisë;
- Kompetencë për të marrë pagesa nëpërmjet çeqeve jo të transferueshme të regjistruara në emër të Shoqërisë;
- Të kryejë para çdo enti tjetër publik dhe privat operacione të tërheqjes dhe heqjes së kufizimeve mbi shumat dhe vlerat, urdhrave, dokumentave dhe korrespondencës, duke lëshuar faturë të plotë dhe formale si dhe operacione depozitimi dhe çdo aktivitet tjetër, pa asnjë përjashtim;
- Të kërkojë pagimin e çdo shume, gjithësesi dhe nga cilido e kërkueshme, duke lëshuar për këtë qëllim urdhra ndaj debitorëve, duke bërë zbritje, arkëtuar, vërtetuar dhe protestuar efektet kambiale dhe titujt nominal, duke kryer çdo operacion tjetër që lidhet me të;
- Kompetencë për të kryer derdhje në llogaritë bankare të Shoqërisë;

Kompetenca në fushën gjyqësore:

- Kompetencë për të përfaqësuar Shoqërinë para çdo autoriteti gjyqësor civil, administrativ, penal, të çdo lloji dhe në çdo fazë të procedurës përgatitore, si përsa i përket gjykimeve të zakonshme dhe atyre të posaçme, vendosjes së garancive dhe ekzekutimit të detyrueshëm si dhe në procedurat e falimentimit, duke ushtruar çdo aktivitet të nevojshëm për këtë qëllim, përfshirë emërimin dhe shkarkimin e avokatëve, përfaqësuesve të posaçëm, këshilltarëve teknik, arbitrave edhe në procedurat e arbitrazheve, dhe të zgjedhin si vendqëndrim një vend të ndryshëm nga selia e Shoqërisë;
- Kompetencë për të kërkuar dhe deklaruar kredi dhe për të ushtruar të gjitha të drejtat e kreditorit;
- Kompetencë për të kryer akte të karakterit ekzekutiv, të kërkojë fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm dhe sekuestron ndaj debitorëve dhe të tretëve dhe të kujdeset për revokimin tyre, të ndërhyjë dhe marrë pjesë në ankande gjyqësore;
- Kompetencë për të përfaqësuar Shoqërinë para organeve kompetente në fushën e së drejtës së punës, në çdo shkallë e gradë, ashtu sikurse në rrugë jashtëgjyqësore, sindikale, arbitrazhi dhe para çdo organi kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të punës, duke pasur kompetencat më të gjera, përfshirë edhe ato të emërimit dhe shkarkimit të avokatëve, përfaqësuesve të posaçëm, të kërkojë zgjidhjen miqësore të mosmarrëveshjeve, të kujdeset për ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë;



- Komptencë për të bërë kërkime ndaj debitorëve, duke vënë në lëvizje edhe veprime ekzekutimi për këtë qëllim;

Kompetenca në fushën fiskale dhe kontabël:

- Në zbatim të dispozitave dhe legjislacionit fiskal në fuqi, të mbajë të gjithë librat kontabël, korrespondencën dhe kontabilitetin në lidhje me aktivitetin e Shoqërisë, të sigurojë përmbushjen e të gjitha detyrimeve të njoftimit, denoncimit dhe depozitimit në regjistrin e shoqërive, në rastet e parashikuara nga ligji;
- Të sigurojë zbatimin korrekt dhe të përpiktë të dispozitave ligjore që lidhen me detyrimet tatimore, valutore dhe doganore të Shoqërisë dhe zbatimin korrekt të tatimeve, taksave dhe të detyrimeve doganore që rëndojnë mbi aktivitetet, kontratat ose aktet e Shoqërisë, përfshirë për shembull edhe trajtimin e saktë fiskal të shpenzimeve të realizuara nga Shoqëria dhe të kushteve në lidhje me denoncimet, deklaratat, kërkesat për pajisje me autorizime, njoftimet, kërkesat dhe të tjera të ngjashme;
- Të verifikojë nëse Shoqëria përmbush detyrimet në bazë të konventave ndërkombëtare, nëse janë të aplikueshme dhe të ligjeve dhe normave rregulluese si kombëtare dhe vendore;
- Të përfaqësojë Shoqërinë në çdo mosmarrëveshje fiskale, ashtu sikurse në çdo procedurë fiskale, përfshirë kompetencat për të nënshkruar e paraqitur deklaratat që kanë lidhje me tatimet e drejtpërdrejta dhe indirekte, deklaratat e mbajtjes së tatimit në burim dhe çdo deklaratë tjetër të kërkuar nga ligji apo organet tatimore;
- Të përfaqësojë Shoqërinë para çdo autoriteti tatimor duke pasur të drejtën të lidhë marrëveshje për shlyerjen e detyrimeve tatimore, të kërkojë fillimin dhe të marrë pjesë në zhvillimin e gjykimit të mosmarrëveshjeve, të kundërshtojë vendimet, apelimet dhe të paraqesë parashtrësia në çdo gjykim si edhe të kërkojë dhe të arrijë marrëveshje për rimbursimin e tatimeve dhe taksave, duke lëshuar vërtetime të pagesave të kryera;
- Të nënshkruajë të gjitha deklaratat, në lidhje me operacionet e eksportit dhe importit;
- Të kryejë çdo akt tjetër që ka të bëjë me këtë fushë, i cili konsiderohet i përshtatshëm dhe në interes të Shoqërisë.

Kompetenca në fushën e privacy dhe të sigurisë në punë:

- Komptencë për të emëruar dhe për të vendosur në krye të përpunimit të të dhënave personale, një ose më shumë persona përgjegjës, mbi bazën e kritereve të caktuara nga legjisacioni në fuqi, të cilët duhet të përzgjidhen në përputhje me kushtet e përcaktuara;
- Komptencë për të përfaqësuar Shoqërinë në çdo marrëdhënie të saj me personat fizik, juridik, me entet dhe shoqatat, të cilave u referohen të dhënat personale si dhe me subjektet e deleguar prej tyre;





- Kompetencë për të përfaqësuar Shoqërinë në marrëdhëniet e saj me teknikët, këshilltarët dhe bashkëpunëtorët e jashtëm si dhe me furnizuesit dhe subjektet e tjera me të cilët bëhet e nevojshme ose e dobishme mbajtja e marrëdhënieve me qëllim zbatimin sa më të mirë të legjislacionit në fuqi;
- Kompetencë për të siguruar për llogari të Shoqërisë, zbatimin e përpiktë dhe korrekt të normave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi përfshirë dispozitat që detyrojnë për kryerjen e denoncimeve dhe kërkesave për autorizime;
- Të kryejë çdo akt, kontratë apo dokumentacion që lidhet me parandalimin e dëmtimeve gjatë kryerjes së veprimtarisë së Shoqërisë; të përfaqësojë Shoqërinë ndaj enteve të caktuara për këtë qëllim, duke nënshkruar procesverbale, kërkesa, ankesa apo rekurse; të zbatojë çdo masë të nevojshme apo të dobishme për parandalimin e dëmtimeve edhe duke kërkuar konsulencën paraprake të ekspertëve.

NENI 10

Shpenzimet e nevojshme deri në themelimin e shoqërisë janë në ngarkim të shoqërisë, e cila me rregjistrimin e saj i merr përsipër këto shpenzime si detyrime të saj.

NENI 11

Mosmarrveshjet që mund të lindin midis paleve brenda dhe jashtë shoqërisë, zgjidhen nga Gjykata kompetente shqiptare, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.

NENI 12

Për sa nuk është shprehur në këtë akt-themelimi, shoqëria i referohet çdo ligji të vecantë perkates që është në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 13

DISPOZITA PERFUNDIMTARE

Autorizohet Elton Shametaj për të ndjekur procedurat ligjore duke përfaqësuar shoqërinë "**Extra-Tech**" me administratorët Z.Erikson Cakoni dhe Z.Sokol Xheneti pranë QKR, Tatimeve, Bashkisë, bankave të nivelit të dytë si dhe pranë çdo institucioni tjetër publik, shtetëror apo subjekt privat ku shoqëria ka interesa të drejtperdrejta.




NENI 14

GJUHA

9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKU

Z.Erikson Cakoni



ORTAKU

Z.Sokol Xheneti

